REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 693/20
Datë/Datum. 21.09.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**

Për Aktivitetin e Prokurimit **Nr. i AP: Nr. i Prokurimit: 210-20-3493-2-1-1**
Nr. i brendshëm Prokurimit: 205 20 007 211

Sa i përket tenderit për: **Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MEA (ish-MMPH-së) Loto 1 dhe Loto 2.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Gani B. Krasniqi B.I.- D.P.Z "Suzuki"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Miradi e Ulët Fushë Kosovë
(Adresa)

Miradi e Ulët — ***12000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044-689-100/ 045-388-484
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Gani Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

suzuki_gk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

21.09.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

Dyqan i Pavar Zejtar Auto Servis SUZUKI Miradi e ulët

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1.Njoftimi për kontrat e përgaditur ne DT me 08.07.2020 dhe e publikuare ne plateformen e-prokurimi – https://e-prokurimi.rks-gov.net/ me 10.07.2020

2.Njoftimi për dorëzimin e dosjes së tenderit: 19.08.2020.

3.Hapja e tenderit: 19.08.2020 ora 11:00

4.Kriteret e Dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

5.Njoftimi mi vendimin e Autoriteti Kontraktues: 15.09.2020

6.Leter standarte per tenderusin e eliminuar:15.09.2020

7.Me datën 16.09.2020 kemi bër kërkesën për Rishqyrtim pran Autoriteti Kontraktues.

8.Me datën 16.09.2020 Autoriteti Kontraktues me vendimin e vet me numer reference 4146/20, benë vendimin për pezullimin e aktivitetit te prokurimit me titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MEA (ish-MMPH-së).

9.Me datën 16.09.2020 Autoriteti Kontraktues me vendimin e vetë me numer reference 4154/20 refuzon kërkesën tonë per rishqyrtim sit e pa bazuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

Kompania jonë nuk ka marre pjesë ne procesverbalin të hapjes se tenderit, por me datën 19.08.2020,ne ora 11:35, e kemi pranuar permes platformes të e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, supozojm se Autoriteti Kontraktues Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka bëre shkeljen e dispozitave te LPP-së **Neni 1,** Qëllimi. **Neni 6,** Ekonomiciteti dhe Efikasiteti. **Neni 7,** Barazi në Trajtim/Jo-Diskriminimi. **Neni 59,** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. **Neni 69,** Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ne përputhje me Njoftimin për kontrat të datës: 10.07.2020, bën publike aktivitetin e prokurimit me titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MEA (ish-MMPH-së).Dhe me datë 19.08.2020,pranon (6) oferta te operatorve ekonomik për këtë aktivitet te prokurimit.

Autoriteti Kontraktues me rastin e Zhvillimit te këti aktiviteti te prokurimit-si dhe me rastin mbi Refuzimin e Kërkesës sonë për rishqyrtim ka bërë shkelje të LPP-së,përkatësisht ka bërë shkelje të:

Neni 1, Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,por ne këtë rast Autoriteti Kontraktues Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit nuk e ka arritur qellimin e ketij tenderit duke mos respektuar ne tersi dizpozitat e LPP-së, dhe duke mos i respektuar ne mënyrën me efikase fondet publike.

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, duke e rekomanduar për shpërblim me kontratë OE "Ndërmarrjen Tregtare Private Miri"me seli ne Prishtinë, dhe na eliminon ne si operatorë ekonomik i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, me arsyetim se nuk i kemi dhenë dëshmi te kërkuara dokumentacion te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Pika 1.Hapësira e objektit-servisit. -Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Ne Njoftimin për kontrat dhe ne dosjen e tenderit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Pika 1

Kapaciteti teknik dhe professional:

1.Operatori ekonomik (OE) pjesëmarrës duhet të posedoj Hapësirë të objektit-servisit ose të marrë me qira, minimumi 230 m2 dhe hapësirë përcjellëse me parking për minimum 5 automjete duke përfshirë edhe sistemin e kamerave (e tërë hapësira duhet të jetë nën vëzhgimin e kamerave për monitorimin e hapësirës ku servisohen automjetet dhe parkingu; Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë reshjet, era, pluhuri, etj. Hapësira e objektit -servisit, duhet të jetë larg maksimumi 15 kilometra, nga ndërtesa e MEA (ISH-MMPH-së), ish- Pallat ii Rilindjes, Prishtinë. Nëse ndodhet më larg se 15 km nga ndërtesa e MEA (ISH-MMPH-së , OE fitues obligohet ta bëjë transportin e të gjitha automjeteve të ish -MMPH-së nga ndërtesa qendrore deri te autoservis i OE, si dhe anasjelltas me shpenzimet e tyre!

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Hapësira e objektit-servisit, të dëshmohet me deklaratë me shkrim mbi vendndodhjen e servisit dhe me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Duhet te deshmoj hapesiren e kerkuar me dokumentacionin i cili posedon hapesiren ne baze te metrave te kerkuar dhe largesin nga objekti ish-Rilindja.

-Ne si operatorët ekonomik bazuar ne njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit kemi dëshmuar Hapësiren e objektit-servisit me Fletë poseduse me nr.**14-942-18149** me **Aktvendim i datës 17.10.2013, me nr.75 (Ku APROVOHET kërkesa e Subjektit Afarist D.P.Z "Suzuki" për ushtrimin e veprimtarisë afarist)**,Kopja e Planit, Certifikatën e Tatimpagusit Dëshmia nga Departamenti i Tatimit në Pronë nga Komuna e Fushë Kosovës e nënshkruar dhe e vulosur ku dëshmohen hapësira e objektit servisit me **324m2**, numrin e objektit të ndertuar: **82187819195**, fatura e tatimit në prone, Vërtetim me të cilin vërtetohet se jemi tatimpaguesi per objekin-servisin, me të gjitha dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi. Bazuar ne këtë që u cek me lartë konstatojme se nuk egziston dëshmi me te madhe për pronësi, nuk ka asgje tjetër se sa Kopja e planit si dhe certifikata e pronesise(fleta poseduse)me nr.**14-942-18149**. Ndersa per AK dëshmite e ofruara nga ana jonë nuk e plotesojne kriterin e kërkuar pronësin për hapësirën e objektit. Konstatimi i AK eshte i paqendrueshëm dhe si te till eshte i pabazuar, ku thuhet OE posedon me hapësirën e objektit vetem **92m2**.

-Përmes sqarimit te tenderti të dates: 06.08.2020 Autoriteti Kontraktues bën shkeljen e,LPP-së.

Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Duke vëndosur kriter diskriminus ne sqarim,ka kërkuare Leje ndërtimi për objektin-servisn, dokumentacion I cili nuk është kriter I cekur as në njoftim për kontratë dhe jo ishenuar në FTD, me anë te këti sqarimi autoriteti kontraktues vendos një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik, me njoftimin mbi vendimin autoriteti kontraktues te datës: **15.09.2020.** Autoriteti kontraktues eliminon 3 operatorët ekonomik(1. Gani B. Krasniqi B.I.- D.P.Z "Suzuki" 2.Hamdi Rrahmani B.I 3.Automative Group SH.P.K N.T.SH BESI) per te njejtin kriter diskriminus Leje ndërtimi e objektit-servisit. Leje ndërtimi nuk percakton dëshmi per pronësi, dhe per neve eshte e pakjarte se si AK e ka trajtuar Lejen e ndërtimit si dëshmi per pronësi por ky është kriter i cili vlersimin e tendertit e ka devijuar nga dispozitat ligjore,me subjektivitetin me elemente te OE i rekomanduar për shpërblim të kontratës.

-Më datën 04.09.2020 duke u bazuar ne Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë,autoriteti kontraktues bën shkeljen e LPP-së përkatësisht:

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafin 2,4 ku citohet:

2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të

përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Ne këtë rast autoriteti kontraktues kërkon nga operatorët ekonomik **Gani B. Krasniqi B.I. - D.P.Z "Suzuki"** qe te ja dergojm leje ndërtimi, dokumentacion I cili nuk është kriter I cekur në njoftimin per kontrat dhe në dosjen e tenderit,por vetem sqarim, por me këte sqarim AK nuk e ka përdorur Formularin B54, Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuar, edhe ta përdorte këtë formular përseri kërkesa e AK për leja ndërtimi do të ishte diskriminim per OE konkurues.

Bazuar ne Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. **Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**, Autoriteti kontraktues mund të kërkon nga operatorë ekonomikë qe të dorëzojmë, plotësojnë, sqarojmë apo kompletojmë informacionin apo dokumentacionin e duhur, siq është I shënuara ne njoftimin për kontratë dhe në FDT, qe për autoritetin kontraktuese Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit duket të jetë jo i plotë ose i gabuar,ose të I qartësojë dokumentet e paraqitura nga ana jonë, por jo kriter diskriminimi I cili kriter nuk është ne përputhshmëri me të gjitha kërkesat ne njoftimin per kontratë dhe në FDT.

Neni 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1.Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

Ne letër standarde për tenderuesin e eliminuar te OE-s Gani B.Krasniqi B.I. - D.P.Z "Suzuki" Autoriteti kontraktues citon Objektin të cilin ju e keni ofruar posedon vetem vetëm 92m2. Autoriteti Kontraktues Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dokumentacion tonë përkatës zyrtar për pronësin e objektit-servisit nuk e merrë si konsiderat ku dëshmohen 324m2, dhe e verifikuar nga dy antaret e komisionit me datën 11.09.2020, ne procesverbalin e verifikimit te deshmive anetaret e komisionit në procesverbalin e tyre vertetojne së operatori ekonomik pjesëmarres Gani B.Krasniqi B.I. - D.P.Z "Suzuki" i plotëson te gjitha kriteret, dhe eshte ne përputhshmëri me të gjitha kërkesat ne njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, në letren standarde per tenderuesin e eliminuar Autoriteti kontratues bie ndesh më veteveten e vet,kur në teren te OE komisjoni konfirmojn se i ploteson kriteret ne njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit ,por nuk posedon leje ndërtimi per hapësiren e objektit-servisit.Por bazohet në sqarimin e thenë te dates 06.08.2020, ku thuhet Të nderuar ju njoftoj se me kërkesën tonë Dokument zyrtar është nënkuptuar "Leje ndërtimi e objektit te cilin e posedon OE konkurrues" nuk është kriter I vendosur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, por vetem sqarim diskriminus.

Ne letrën standarde per tenderuesin e eliminuar AK konstaton se kompania e jone posedon vetem **92 m2** ndersa komisioni i vleresimit ne vend ngjarje pasi ka verifikuar

hapsiren e objektit i njejti ka konstatuar aty per aty se objeti -servisi i ploteson te gjitha kërkesat qe kane qene te parapara ne FTD. Për neve eshte e quditshme kur ne posëdojme te gjith dokumentacionin per pronësi, ndersa AK citon se posedon tjeter dokumentacion. Cilit dokumentacion ti besojme atij qe ne kemi ofruar, origjinal e nënshkruar dhe e vulosur apo atij qe AK, e ka pikturuar ne vendimin e vetë me numer reference 4154/20 . Me datën 16.09.2020 Autoriteti Kontraktues me vendimin e vetë me numer reference 4154/20 refuzon kërkesën tonë per rishqyrtim sit e pa bazuar,dhe AK na shantazhon,kercenon gjoje se nje pjes e objekti-servisit nuk gjindet ne pronen tonë.Prandaj për neve eshte ofenduese kur AK deklaron qe ne nuk posedojmë objektin-servisin e kerkuar.

Vëmendje:

Veni re profesionalizmin e Autoriteti kontraktues dhe te z.Ndriçim Mustafa udhëheqës i Divizionit të Prokurimit.

Me datën 26.07.2018 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor (z.Ndriçim Mustafa udhëheqës i Divizionit të Prokurimit.) dhe D.P.Z "Suzuki"(Gani Krasniqi) lidhin kontrat publike kornizë për Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPH-së me numër prokurimi: 210-18-2964-2-2-1.AK-MMPH ne përputhje me Njoftimin për kontratë të datës: 16.05.2018 bën publike aktivitetin e prokurimit me Titulli: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPH-së, per të njejtin aktivitet prokurimi me Kërkesat e njejta mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, **Pika 1.Hapësira e objektit-ve të servisit duhet të jetë minimum 200 m2. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë: reshjet, era, pluhuri kërkohet për pjesën 1, pjesën 2,** e me datën 16.07.2018, AK MMPH-së shpërblenë me kontrat operatorët ekonomik D.P.Z "Suzuki"Miradi e Ulët. Me datën 15.09.2020, me letër standarde per tenderusin e eliminuar i njejti Autoriteti kontraktues, i njejti udhëheqës i Divizionit të Prokurimit për të njejtin aktivitet prokurimi, për të njejtin kriter na eliminon si OE i pa pergjigjshem. Nuk je ne përputhshmëri me të gjitha kërkesat te njoftimit për kontratë dhe dosjes te tenderit,per arsyje se posedoni vetëm **92m2,** te objekti-servisit, a ne vitin 2018 kur AK na shpërblen me kontratë ne si OE i posedojshum Hapësirën e objektit-servisit me mbi 200m2, si dëshmi (njoftimin për kontratë te datës: 16.05.2018, kopjen e kontratës dhe referencën).

Me datën 16.09.2020 Autoriteti Kontraktues me vendimin e vetë me numer reference 4154/20 refuzon kërkesën tonë per rishqyrtim sit e pa bazuar. Autoriteti Kontraktues thotë ku citojm, Komisjoni i vlersimit ka ardhur ne perfundim qe OE pjesemarres eshte i pa pergjigjshem, per arsyje se nuk ka permbushur këtë kriter, pasi qe nje pjes e objektit nuk gjindet ne pronen e OE pjesemarrës, sipas opinjonit te AKK-së, dhe OE posëdon me hapësirë e objektit me vetëm me **92m2.**

Autoriteti Kontraktues në kundershtim me rregullat dhe nenet e cekura më lartë fatëkeqisisht vendosë te na eliminoj ne si OE përgjegjshëm dhe ta rekomandoj për shpërblim me kontratë OE me Çmimi me te lartë se ne.

Nga Dëshmit dhe faktet e lartë cekura i propozojmë Panelit shqyrtues të **OSHP**-së që ankesesn tonë ta aprovoj si të bazuar ndersa këtë aktivitet te prokurimit ta kthej ne rivlersim.Dhe te anuloj Vendimin e Autoriteti kontraktues me Numer **4154/20** të datës 16.09.2020, përmes te cilit vendim na është refuzuar kërkesa jone për rishqyrtim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani shumë serioze, me një përvojë shume te gjate në këtë fushë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Në vijim ju prezantojm dëshmit dhe provat e dorzuar te dokumentacion përkatës zyrtar për Hapësirën e objektit-servisit.

1.Fletë poseduse, me nr: 14-942-18149

2.Aktvendim- i datës 17.10.2013, me nr.75 (Ku APROVOHET kërkesa e Subjektit Afarist D.P.Z "Suzuki" për ushtrimin e veprimtarisë afarist),

3.Kopja e Planit,e Objektit-servisit.

4.Certifikatën e Tatimpagusit, Gani B. Krasniqi B.I. - D.P.Z "Suzuki" nga Departamenti I Tatimit në Pronë nga Komuna e Fushë Kosovës e nënshkruar dhe e vulosur ku dëshmohen hapësira e objektit servisit me 324m2.

5.Numrin e objektit të ndertuar: 82187819195.

6.Fatura e tatimit në prone,ku dëshmohet se jemi tatim paguse per objektin-servisin

7.Vërtetim me të cilin vërtetohet se jemi tatimpaguesi si kompani per objekin/servisin

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*